

37.027
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR 37027 VENDIMIT

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me date 05.10. 2006, une gjyqtarja M. Vucica
pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur prej zotit Endri Fuga, per regjistrimin si
person juridik te shoqerise,

KONSTATOVA

Se me vullnetin e lire te paleve ortake, eshte hartuar Statuti dhe Akt Themelimi
per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar si me poshte :

Emri I Shoqerise eshte "A.C.G" shpk (Albanian Communication GROUP)
Ortaket Themelues te saj jane : Z.Endri Fuga, Z.Arbjan Mazniku dhe Z.Sokol
Shameti.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- 1.Veprimtari ne fushen e botimeve, vecanerisht:
 - botimi i Revistes "MAPO" (Magazina Popullore).
- 2.Import- Export i lendeve te para dhe teknologjise per shtypshkrime.
- 3.Veprimtari marketingu:
 - ne fushen e reklamave, publikimeve,
 - fushata promovuese.
- 4.Sondazhe (anketime).
- 5.Konsulence per marredhenie me publikun dhe komunikim.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte krijuar nga kontributet ne para ne vleren
100.000 (njqinde mije) leke.

Kontributi i Ortakeve ne krijimin e tij dhe pjeset takuese te fitimit nga kjo
veprimtari jane perkatesisht per secilin si me poshte :

- Zoti Endri Fuga me 55 %
- Zoti Arbjan Mazniku me 30 %
- Zoti Sokol Shameti me 15 %.

Kohezgjatja e veprimtarise eshte e pakufizuar.

Qendra (Selia) e Shoqerise eshte ne Tirane, rruga "Gjin Bue Shpata" Pallati 9/A, Ap.48.

Administratori i shoqerise, i caktuar ne statut eshte Zoti Endri Fuga, biri i Perparimit, dl. 11.11.1981, lindur dhe banues ne Tirane, rruga e Barrikadave, Pallati 4, ap.10.

Si perfaqesues ligjor i shoqerise, Administratori, paraqet kerkesen per regjistrimin e shoqerise se mesiperme. Bashkengjitur saj, Statuti dhe Akti i Themelimit te nenshkruar nga Ortaket, certificate e mbajtesit te fondeve qe rjedhin nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar, dokument arketimi nr. 00019/ 0106799918, date 04.10.2006, nga Raiffeisen BANK, (vula 001003) Tirane.

Nga shqyrtimi i kerkeses dhe akteve bashkengjitur, rezulton se ajo eshte e drejte dhe duhet pranuar.

PER KETE ARESYE :

Ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe Ligjit Ligji 7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar dhe formalitetet...."

VENDOSA :

Pranimin e kerkeses.

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin "A.C.G" shpk (Albanian Communication GROUP).

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

1. Veprimtari ne fushen e botimeve, vecanerisht:
 - botimi i Revistes "MAPO" (Magazina Popullore).
2. Import- Export i lendeve te para dhe teknologjise per shtypshkrime.
3. Veprimtari marketingu:
 - ne fushen e reklamave, publikimeve,
 - fushata promovuese.
4. Sondazhe (anketime).
5. Konsulence per marredhenie me publikun dhe komunikim.

Kapitali themeltar i nenshkruar me kontribute ne para, eshte ne vleren 100.000 (njqinde mije) leke.

Ortake themelues, kontributet ne krijimin e ketij kapitali dhe pjeset takuese te fitimit sipas ketij kontributi jane perkatesisht :

- 1. ZOTI ENDRI FUGA me 55 %**
- 2. ZOTI ARBJAN MAZNIKU me 30 %**
- 3. ZOTI SOKOL SHAMETI me 15 %.**

Kohezgjatja e veprimtarise eshte e pakufizuar.

Qendra (Selia) e Shoqerise eshte ne Tirane, rruga "Gjin Bue Shpata", Pallati 9/A, Ap.48.

Administratori i shoqerise, i caktuar ne statut eshte Zoti Endri Fuga, biri i Perparimit, dl. 11.11.1981, lindur dhe banues ne Tirane, rruga e Barrikadave, Pallati 4, ap.10.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQ TAR
Blendi Lleshi
P. Lleshi

VENDIM
I GJYQITARIT TË VETËM

Spt. më datë 29/3/2007, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor - Tiranë, Znj. M. Dajç, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria A.C.G. sh.p.k., lidhur me depozitimën pranë Regjistrimit Tregtar të Vendimit të Asamblese se Shoqërisë date 8.2.2007 si edhe të Kontratës së Transferimit të Pjesëve të Kapitalit të Shoqërisë midis Z. Sokol Shameti dhe Z. Endri Fuga datë 08.02.2007, si dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur kërkesës,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria **A.C.G. sh.p.k.** është regjistruar në Regjistrimin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim nr. 37027 të datës 05.10.2006.

Më datë 08.02.2007 është lidhur Kontrata për Transferimin e Pjesëve të kapitalit midis ortakut Z. Sokol Shameti dhe ortakut tjetër Z. Endri Fuga nëpërmjet se ciles Z. Sokol Shameti që zotëron 15 pjesë kapitali ose 15 % të kapitalit të Shoqërisë I ka transferuar nëpërmjet shitjes këto pjesë kapitali tek ortakut Z. Endri Fuga.

Me datë 08.02.2007 me vendimin e Asamblese se ortakëve të Shoqërisë është vendosur miratimi i transferimit nëpërmjet shitjes të pesëmbëdhjetë pjesëve të kapitalit të Shoqërisë që përbëjnë 15 % (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë nga ortakut i saj Sokol Shameti tek ortakut tjetër Endri Fuga si dhe miratimi i Kontratës përkatëse për transferimin e pjesëve të kapitalit date 8.2.2007. Si rrjedhojë e vendimeve sa më sipër struktura e kapitalit të Shoqërisë është si më poshtë:

Ortakut	Zoterimi i pjesëve të kapitalit në %	Nr. Pjesëve të kapitalit	Vlera në Leke e kapitalit të Shoqërisë
Endri Fuga	70	70	70.000
Arbjan Mazniku	30	30	30.000

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar" dhe ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për regjistrimin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

- Të pranoj kërkesën e bërë nga Shoqëria ACG sh.p.k.;
- Të urdhëroj Depozitimën në zyrën e Regjistrimit Tregtar të Vendimit të Asamblese se Shoqërisë date 8.2.2007; si edhe të Kontratës së Transferimit të Pjesëve të Kapitalit të Shoqërisë datë 08.02.2007 lidhur midis Z. Sokol Shameti dhe Z. Endri Fuga. Struktura e kapitalit të Shoqërisë është si më poshtë:

Ortakut	Zoterimi i pjesëve të kapitalit në %	Nr. Pjesëve të kapitalit	Vlera në Leke e kapitalit të Shoqërisë
Endri Fuga	70	70	70.000
Arbjan Mazniku	30	30	30.000

Tiranë, më 29/3/2007

GJYQTARE
M. Dajç

AKT THEMELIMI



I hartuar me vullnetin e lirë dhe për interes të përbashkët midis palëve pjesëmarrëse si vijon:

ENDRI FUGA, biri i Përparimit, dl. 11.11.1981, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga e Barrikadave, pallati 4, ap.10.

ARBAN MAZNIKU, biri i Cvetkos, dl. 06.11.1978, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga "Arkitekt Kasemi" nr.24.

SOKOL SHAMETI, biri i Avdulit, dl. 29.04.1978, lindur në Gjirokastrë, banues në Tiranë, Rruga "Fadil Rada", pallati 11, shkalla 2/36.

I cili ka për qëllim krijimin e shoqërisë tregtare për të ushtruar veprimtari fitimprurëse, në përputhje me Ligjin 7638 datë 19.11.1992 dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që rregullon këtë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

NENI 1

EMERTIMI

Emërtimi i shoqërisë tregtare është "A.C.G" sh.p.k. (ALBANIAN COMMUNICATION GROUP).

NENI 2

OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë :

- 1.Veprimtari në fushën e botimeve, vecanërisht: botimi i Revistes "MAPO" (Magazina Popullore).
- 2.Import- Export i lëndëve të para dhe teknologjisë për shtypshkrime.
- 3.Veprimtari marketingu: në fushën e reklamave, publikimeve, fushata promovuese.
- 4.Sondazhe (anketime).
- 5.Konsulencë për marrëdhënie me publikun dhe komunikim.

NENI 3

QENDRA

Qendra (Selia) e shoqërisë: Tiranë, Rruga "Gjin Bue Shpata".Pallati 9/A.Ap .48.

NENI 4

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është në vlerë 100.000 (njëqind mije) lekë. Ky kapital ndahet në 100 kuota me Vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë. Kushtet për transferimin e kuotave të kapitalit, zmadhimin e zvogëlimin e tij, përcaktohen në Statutin e nënshkruar të Shoqërisë.

2

Neni 5

KONTRIBUTI I ORTAKEVE

Kontributi i ortakëve në krijimin e tij është:

- | | |
|-------------------|---|
| 1. Endri Fuga | kontribues në 55 % (pesëdhjetë e pesë për qind) |
| 2. Arbjan Mazniku | kontribues në 30 % (tridhjetë për qind) |
| 3. Sokol Shameti | kontribues në 15 % (pesëmbëdhjetë për qind) |

Në po këto raporte do të ndahet edhe fitimi midis palëve.

NENI 6

KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Personaliteti juridik i saj fitohet me regjistrimin në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

ADMINISTRIMI

Administrator i shoqërisë i caktuar nga ortakët themelues në këtë statut është zoti Endri Fuga, datëlindja 1981, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga e Barrikadave, Pallati 4, apartamenti 10.

Kompetencat e tij, të drejtat dhe detyrimet, kriteret për shkarkimin e tij, përcaktohen në statutin e shoqërisë dhe Ligjin 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

NENI 8

ORGANI VENDIMARRËS

Organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Kompetencat, natyra e mbledhjes së Asamblesë (e zakonshme dhe e jashtëzakonshme), mënyrat e thirrjes, kriteret për vlefshmërinë e vendimeve të marra, përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 9

PERGJEGJESITE PER HUMBJET

Humbjet nga veprimtaria e shoqërisë përballohen nga ortakët në përpjestim me vlerën e kontributit të tyre për krijimin e kapitalit themeltar. Shoqëria nuk përgjigjet për

humbjet e ortakëve jashtë veprimtarisë së saj. Shteti nuk përballon humbjet e shoqërisë dhe anasjelltas.

NENI 10

DEGET. FILIALET.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë dhe filiale të saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Ajo ka të drejtë të bashkohet ose të thithë shoqëri të tjera.

NENI 11

PRISHJA

Shoqëria priset:

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Në rast falimentimi si dhe për raste të tjera parashikuar nga Ligji përkatës.

NENI 13

GJYKIMI I MOSMARREVESHJEVE


Kompetente për gjykimin e mosmarveshjeve midis ortakëve, nëse ato nuk zgjidhen me pajtim, është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Akti themelimit hartohet në katër ekzemplarë dhe nënshkruhet me vullnetin e lirë të ortakëve themelues.


Ky akt themelimi është i vlefshëm bashkëngjitur me Statutin e Shoqërisë.

ORTAKET

Arbjan Mazonika
emri, mbiemri, firma



ENDRI FUGA
emri, mbiemri, firma



SOHOL SHAMETI
emri, mbiemri, firma



KY STATUT është hartuar me vullnetin e lirë të zotërinjve:

- **ENDRI FUGA**, biri i Përparimit, dl. 11.11.1981, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga e Barrikadave, pallati 4, ap.10.
- **ARBAN MAZNIKU**, biri i Cvetkos, dl. 06.11.1978, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga “Arkitekt Kasemi” nr.24.
- **SOKOL SHAMETI**, biri i Avdulit, dl. 29.04.1978, lindur në Gjirokastrë, banues në Tiranë, Rruga “Fadil Rada”, pallati 11, shkalla 2/36. Mbështetur në dispozitat përkatëse të Ligjit 7638 dt. 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, Ligjit 7667 datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare” me përmbajtjen si më poshtë :

NENI 1

EMRI, FORMA E SHOQERISE. PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria ka emrin “A.C.G” sh.p.k. (ALBANIAN COMMUNICATION GROUP). Ajo është e formës “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, e cila do të ushtrojë veprimtari tregtare me qëllim fitimprurës që i nënshtrohet legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe rregullohet nga dispozitat e këtij Statuti, i cili sipas nenit 3 të Ligjit 7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, ndër të tjera përcakton formën, kohëzgjatjen, emërtimin, objektin e veprimtarisë dhe shumën e kapitalit themeltar. Në të gjitha aktet e dokumentat që dalin prej shoqërisë, emërtimi i saj do të paraprihet (ose të ndiqet menjëherë) nga inicialet “sh.p.k” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar. Personaliteti juridik i shoqërisë, fitohet me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar.

NENI 2.

OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë është :

1. Veprimtari në fushën e botimeve, vecanërisht:
 - botimi i Revistes “MAPO” (Magazina Popullore).
2. Import- Export i lëndëve të para dhe teknologjisë për shtypshkrime.
3. Veprimtari marketingu:
 - në fushën e reklamave, publikimeve,



fushata promovuese.

4.Sondazhe (anketime).

5.Konsulencë për marrëdhënie me publikun dhe komunikim.

Brenda kuadrit të dispozitave ligjore, Shoqëria ka të drejtë të marrë masat dhe të kryejë cdo biznes të përshtatshëm për arritjen e qëllimeve të saj, kjo e cila përfshin krijimin e filialeve, degëve të saj brenda dhe jashtë territorit të RSH.

NENI 3.

ORTAKET THEMELUES

Ortakët themelues të kësaj shoqërie janë :

- 1 .Zoti Endri Fuga**
- 2. Zoti Arbjan Mazniku**
- 3 .Zoti Sokol Shameti**

NENI 4.

QENDRA E SHOQERISE

Qendra,(selia) e Shoqërisë është në Tiranë, - Rruga “Gjin Bue Shpata”, Pallati 9/A, Ap.48. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, ajo mund të transferohet në cdo vend tjetër në territorin e RSH.Në rastin e ndryshimit të selisë, Administratori është i autorizuar të kërkojë regjistrimin e ndryshimeve të bëra në Statut.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR,KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbehet nga kontribute në para në shumën prej 100.000 njëqindë mijë leke.Ai ndahet në 100 kuota me vlerë nominale 1.000 leke secila. Pjesët (kuotat) janë vlerë pasurore. Ndalohet emetimi i letrave me vlerë nga shoqëria

Në momentin e themelimit të shoqërisë, me nënshkrimin e këtij Statuti, kontributet në para për shumën e mësipërme janë shlyer plotësisht nga secili Ortak si më poshtë :

- 1. Endri Fuga - kontribues në 55 % (pesëdhjetë e pesë për qind)**
- 2.Arbjan Mazniku- kontribues në 30 % (tridhjetë për qind)**
- 3. Sokol Shameti -kontribues në 15 % (pesëmbëdhjetë për qind)**

Secili ortak gëzon të gjithë prerogativat që lidhen me këtë cilesi si dhe mbart detyrimet që rrjedhin prej Ortakërisë, deri në kufijtë e vlerës së kontribuar, pjesëve (kuotave) që zotëron.

NENI 6. **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve.

Ortakët vendosin në këtë Statut se:

Transferimi në persona të tretë i kuotave të kapitalit themeltar, i nënshtrohet miratimit të Asamblesë së Ortakëve, në kushtet e nenit 47 të Ligjit 7638 datë 19.11.1992. Ortaku që kërkon transferimin, duhet të njoftojë Shoqërinë për projektin e transferimit. Marrja në shqyrtim e kërkesës për shitje në të tretë, duhet të bëhet nga shoqëria brenda 3 muajve nga data e njoftimit të saj. Nëse Shoqëria nuk përgjigjet, miratimi konsiderohet i dhënë. Në rast refuzimi të miratimit të transferimit, brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi, ortakët e tjerë duhet të lejojnë blerjen e kuotave me vlerën e percaktuar sipas nje eksperti të caktuar nga palet ose në rast mosmarrëveshje, nga gjykata me procedure urgjente.

NENI 7 **KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shkurtimi i kohëzgjatjes në rast të një prishje të përshpejtuar bëhet me Vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.

NENI 8 **ORGANET VENDIM MARRESE TE SHOQERISE.**


Organi me i larte vendim marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Mbledhjet e saj janë të zakonshme (jo me pak se tre herë në vit) dhe të jashtëzakonshme.

Thirrja e Asamblese

Lajmërimi bëhet nga Administratori. Në mungesë të tij mbledhja thirret nga eksperti kontabel i autorizuar. Cdo ortak mund të kërkojë ligjërisht caktimin e një mandatmbajtësi të caktuar për thirrjen e Asamblesë dhe caktimin e rendit të ditës.

Menyra e thirrjes Afati.

Thirrja i drejtohet ortakëve me letër rekomande. Kur ajo është bërë verbalisht dhe është siguruar prania e të gjithë ortakëve ose të të përfaqësuarve të tyre rregullisht, mbledhja është e vlefshme. Por kjo vlefshmëri kërkon që ortakët të kenë ushtruar më parë të drejtën ligjore për t'u njohur me dokumentacionin përkatës që do të paraqitet për shqyrtim në Asamble.



Letërthirja u drejtohet ortakëve të paktën 15 dite para mbledhjes. Letërthirja përcakton ndër të tjera:

Rendin e ditës, vëndin e mbledhjes, orën.

Thirrja e mbledhjes së Asamblesë në kundërshtim me procedurat e mësipërme është e pavlefshme.

Ortakët jo administratorë kanë të drejtën e komunikimit paraprak për tekstet e vendimeve të propozuara, të Raportit të Administratorit, të Raportit të Ekspertit Kontabel etj. Asnjë ortak nuk mund të pengohet të marrë pjesë në Asamble.

Drejtimi i mbledhjeve të Shoqërise, bëhet nga Administratori i Shoqërise.

Përfaqësimi në Mbledhjet e Asamblesë

Secili ortak në mungesë të tij, mund të përfaqësohet në Mbledhjen e Asamblesë nga një ortak tjetër, por edhe nga një person i tretë me akt të posacëm, duke përcaktuar shprehimisht tagret e dhëna sipër rendit të ditës (neni 58&2, Ligji 7638 date 19.11.1992). Mandati i dhënë është i vlefshëm vetëm për çështje të diskutuara sipas Rendit të ditës. Po kështu edhe për një mbledhje të mëvonshme që thirret si vazhdim i së parës më të njëjtin rend dite. Mandati duhet të jetë tërësor, d.m.th. për të gjitha pjeset e kapitalit që zotëron ortaku i përfaqësuar.

Patjetërsueshmëria e votës. Votimi. Procesverbali.

E drejta e votës në vetvehte është e patransferueshme. Ajo ndjek transferimin e pjesëve (kuotave) të kapitalit themeltar. Cdo ortak disponon një numer votash të barabarte me pjeset e kapitalit themeltar që ai zotëron.

Cdo mbledhje e Asamblese evidentohet në baze të procesverbalit përkates. Ai hartohet në një regjister të posacëm të Shoqërisë, i numërtuar dhe i vulosur. Procesverbali ndër të tjera, përmban: datën dhe vëndin e mbledhjes, emrin e cilësine e drejtuesit të saj, emrin e ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar dhe treguesin e numrit të kuotave të kapitalit themeltar, dokumentet e raportet paraqitur në Asamble, përmbledhjen e debateve, tekstet e projektvendimeve që i nënshtrohen votimit, si ato të miratuara dhe ato të hedhura poshtë.

Procesverbali nënshkruhet nga Administratori dhe mbajtesi i tij, (sekretari).

Kompetencat e Ortakëve. Vetëm ortakët në Mbledhjet e Asamblesë së Zakonshme ose të Jashtëzakonshme, kanë të drejtë :

- të ndryshojne emrin, selinë, objektin, kohëzgjatjen e Shoqërisë.
- të shkarkojnë Administratorin.
- të vendosin për marrje - dhënie të huave, kredi, hipotekë, të lenë peng pasuritë e Shoqërisë.
- të zmadhojnë ose zvogëlojnë kapitalin themeltar,
- të ndryshojnë formën e shoqërisë,
- të vendosin për bashkim, thithje apo shkrirje të shoqërisë me persona juridike,
- të japin autorizim paraprak për nënshkrim të marrveshjeve të shoqërise me një prej ortakëve të saj,
- të vendosin për menyrën e shpërndarjes së dividendit,
- të japin me qera pasuri të shoqërisë,
- të bëhen garant për të tretë në rast të kredive bankare,
- të miratojnë transferimin e kuotave në persona të tretë jo ortakë,

- të emërojnë osë shkarkojnë ekspert kontabël,
- të marrin në shqyrtim llogaritë vjetore e bilancin financiar.

Asambleja e zakonshme

Asambleja e Zakonshme merr cdo vendim përvec atyre që sjellin ndryshime në Statutin e Shoqërisë. Vendimet në Asamblenë e Zakonshme, merren nga ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kuotave të kapitalit themeltar. Në rast se kjo shumicë nuk sigurohet, ortakët thirren, ose sipas rastit, konsultohen për herë të dytë dhe vendimet merren me shumicën e votave të dhena, pavaresisht nga përqindja e kapitalit që ato përfaqësojnë.

Asambleja e Jashtëzakonshme

Vendimet e marra nga kjo Asamble kanë për qëllim të sjellin ndryshime në Statut. Ndryshimet në të vendosen nga ortakët që përfaqësojnë 3/4 (tre të katërtat) e kuotave të kapitalit themeltar.

NENI 9

ADMINISTRIMI

Drejtimi i Shoqërisë kryhet nga Administratori i caktuar me këtë Statut, zoti **Endri Fuga**, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga e Barrikadave, Pallati 4, ap.10.

Kompetencat e Administratorit.

Administratori është përfaqësuesi ligjor që përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretë dhe shoqëria merr persiper detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara prej tyre.

Administratori kryen të gjitha veprimet e administrimit duke ushtruar kompetencat e dhëna nga statuti dhe ato sipas nenit 16, 50 te Ligjit 7638 dates 19.11.1992, me përjashtim të atyre që ky ligj i njeh shprehimisht Asamblesë së Ortakëve. Ky drejtim është i përgjithshëm duke përfshirë veprimet që lidhen me administrim të pasurisë së shoqërisë, por edhe të administrimit të thjeshtë në interes të saj. Veprimet e Administratorit që kryhen brënda objektit të shoqërisë, por qe janë kunder interesave të saj, janë të kundërshtueshme prej ortakëve. Në një rast të tillë shoqëria ka të drejtë të kërkojë zëvendësim të dëmit të pësuar.

Në këtë kuadër, Administratori është personi që kryen njoftimet për Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve, duke respektuar procedurat e njoftimit parashikuar në Nenin 8 të këtij Statuti. Ai paraqet raportin e llogarive përfundimtare vjetore apo cdo projekt të hartuar nga eksperti kontabël i emëruar nga Asambleja e Ortakëve.

Përgjegjësia e Administratorit.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë për shkelje të ligjeve, të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të saj. Shkarkimi i tij bëhet me vendim të Asamblese së Zakonshme të Ortakëve. Vendimi për shkarkim merret nga Ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kuotave të kapitalit themeltar. Por cdo ortak ka të drejtë personalisht t'i drejtohet gjykates kompetente për shkarkimin e tij për veprime të kryera që bien ndesh me ligjin, duke kërkuar kur është e nevojshme edhe



shpërblim të plotë të dëmit financiar të shkaktuar. Nuk përjashtohet për asnje rast dhe me asnje marreveshje, përgjegjësia civile dhe penale e Administratorit. Vendimi për shkarkim fillon efektet nga data e marrjes së tij. Ky ndryshim i nënshtrohet publikimit sipas rregullave ligjore.

Kur pushojnë funksionet e Administratorit për çfarëdo arsye, ai duhet të japë llogari për misionin e tij gjatë drejtimit para Asamblesë që miraton llogarite vjetore të ushtrimit.

Në kuptim të shkëljes së statutit dhe ligjit, apo të veprimeve me faj, përbën arsye për shkarkim ndër të tjera :

- refuzimi i vazhdueshëm i administratorit për t'iu nënshtuar rregullave dhe ligjit « Për Shoqëritë Tregtare », dispozitave të statutit lidhur me miratimin vjetor të llogarive dhe me të drejten e informimit të ortakëve.

- administrimi rrënues, shoqëruar me spekulim utopik të kryer prej tij për mundësinë e një rimëkëmbje të shpejtë të shoqërisë.

- administrimi i keq financiar,

- humbja e besimit të ortakëve, bankierëve dhe administratës publike, ndaj administratorit për faje të tij, që pengon një rimëkëmbje financiare të shoqërisë në një gjendje të tillë,

- politika personale e ndjekur nga administratori dhe rezistenca që i bën sugjerimeve të ortakëve në lidhje me ristrukturimin e shoqërisë, angazhimin dhe kualifikimin e personelit dhe metodat e reklames së shoqërisë në përgjithësi,

- lidhja e një kontrate qeraje në kushte të dëmshme për shoqërinë,

- zbatimi i keq i një vendimi të Asamblesë,

- mospagimi i kuotave të sigurimeve shoqërore kur gjëndja e likuiditeteve të shoqërisë e mundëson këtë,

- mashtrime tatimore,

- kredi akorduar individëve, kur objekti nuk e parashikon një mundësi të tillë.

- neglizhencë që ka sjellë dënimin e shoqërisë për dëmshpërblim financiar për konkurrencë të pandershme.

Kontrolli i Administrimit

Kryhet nga Asambleja e Ortakëve, të thirrur për të vendosur për llogaritë e shoqërisë për vitin ushtrimor financiar të mbyllur.

Marrëveshjet midis shoqërisë dhe administratorit, ose ortakëve të saj i nënshtrohen në parim kontrollit sipas nenit 51&1 të Ligjit 7638 datë 19.11.1992

Procedura

Marrëveshjet që kryhen për operacione të përditshme dhe të kryera në kushte normale nuk i nënshtrohen kontrollit të ortakëve.

Administratori njofton për marreveshjet e arritura brenda afatit 1 muajor nga data e përfundimit të marrëveshjes. Ai përmban në Raport përmëndjen e marrëveshjes që i nënshtrohet miratimit të Asamblesë duke përfshirë: emrin e Administratorit ose të Ortakut të interesuar, natyrën e objektit të marrëveshjes, modalitetet thelbësore, pikërisht cmimet ose tarifën e praktikuar, zbritjet dhe komisionet e akorduara, afatet e pagesave, interesat, garancitë e dhëna dhe kur është rasti cdo tregues tjetër, që mundëson Asamblesë e Ortakëve të cmojnë interesin që ka shoqëria nga marrëveshja e arritur. Në

marrijen e vendimit, në votim nuk merr pjesë ortaku i interesuar dhe pjesa e ketij të fundit nuk merret parasysh në llogaritjen e quorumit dhe shumicës (neni 51&1).

Ndalimet

Administratorit i ndalohet të kontraktojë në cdo formë, qoftë për të marrë hua nga shoqëria, për të siguruar nga shoqëria një paradhënie në llogari rjedhese ose në një formë tjetër, si dhe për ta bërë shoqërinë dorëzanëse apo garantuese të detyrimeve të tij ndaj të tretëve. Këto ndalesa janë të njëjta edhe për cdo Ortak. Pavlefshmëria e këtyre kontratave është pavlefshme absolute e cila kërkohet nga ortakët e nga Shoqëria.

Shpërblimi i Administratorit

Shpërblimi i Administratorit dhe mënyra e llogaritjes precize të tij (fixe, apo në përpjestim me fitimet, të ardhurat), bëhet me vendim të posacëm të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 10

BILANCI, VITI FINANCIAR, E DREJTA PER INFORMIM.

Viti financiar përfshin periudhen nga data 1 janar deri në datë 31 dhjetor të cdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, Raportet mbi operacionet e vitit financiar, miratohen nga Asambleja e Ortakëve. Këto të fundit i nënshtrohen miratimit brenda 6 muajve duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar. Ortakët joadministratorë kanë të drejtë t'u vihen në dispozicion aktet e mësipërme për shqyrtim e të paraqesin pyetje me shkrim.

NENI 11.

EKSPERTI KONTABEL

Shoqëria mund të emëroje Ekspert Kontabël të autorizuar, me vendim të Asamblesë për një periudhe prej 6 vite financiare. Ai ngarkohet me mbajtjen e Kontabilitetit të shoqërisë dhe e ushtron këtë funksion në mënyrë të pavarur nga veprimtaria e shoqërisë. Për emërimin e tij respektohen edhe dispozitat 168, 169 të Ligjit 7638 datë 19.11.1992, në lidhje me përjashtimin dhe papajtueshmëritë.

Modalitetet e emërimit, kompetencat, funksionet e tij përcaktohen në Ligjin cituar më lart. Eksperteti Kontabël njoftohet për mbledhjet e Asamblesë si dhe lejohet të marrë pjesë në të.

Eksperti kontabel i autorizuar detyrohet vecanërisht:

- Të garantojë që llogaritë vjetore janë të rregullta, të hartuara me korrektesë, që japin një pasqyrim besnik të rezultatit të operacioneve të vitit të kaluar financiar si dhe të gjendjes financiare të trashëguar të shoqërisë në fund të vitit financiar në vazhdim.
- Të verifikojë librat e llogarisë dhe të fondeve të shoqërisë dhe përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi.
- Të verifikojë përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna nga raporti i Administratorit.
- Të kryejë kontrollet që i cmon të nevojshme dhe të dobishme dhe në vecanti kontratat, librat e llogarisë, dokumentat kontabël dhe regjistrat e procesverbaleve.



- Të mbledhë informacione pranë të tretëve, që kanë kryer operacione financiare me shoqerine .Të vejë në dijeni Ortakët në mbledhjet e Asamblesë së shoqërisë për rastet e perregullshmërive dhe pasaktësive që ka konstatuar.
 - Të ruajë sekretin profesional lidhur me fakte, akte dhe informacione për të cilat është mundur të vihet në dijeni për shkak të ushtrimit të këtij funksioni.
- Për ushtrim të kundraligjshëm të funksioneve të tij, parashikohen sanksione sipas nenëve 299,300 te Ligjit 7638 datë 19.11.1992.

NENI 12

ZMADHIMI I KAPITALIT

Zmadhimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakëve e cila merr vendim në kushtet e ndryshimeve në statut.Ortakët nuk mund të detyrohen të shtojnë pjesën e tyre të kontributit.

Mënyrat e zmadhimit me kontribute në para :

- Me anë të nënshkrimit të pjesëve të reja: Pjesët (kuotat) e reja mund të nënshkruhen nga vetë ortaket.
 - Me anë të përfshirjes së rezervave dhe fitimit të pashpërndarë.
 - Nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të pjesëve (kuotave) ekzistuese.
- Në këtë rast janë të detyrueshme për zbatim nenet 40 paragrafi i fundit, 41, 62, të Ligjit 7638 datë 19.11.1992.

Mënyrat e zmadhimit në natyrë:

Nëpërmjet hartimit të Raportit për vlerësimin e cdo kontributi në natyrë i hartuar nga një ekspert për kontributet i emëruar në kushtet e nenit 42 dhe 63 të Ligjit 7638 datë 19.11.1992.

NENI 13

ZVOGELIMI I KAPITALIT

Zvogëlimi vendoset nga Asambleja e Ortakëve e cila merr vendim në kushtet e ndryshimit në statut. Në rast zvogëlimi respektohet procedura e emërimit të ekspertit kontabel të autorizuar, të cilit i komunikohet projekti i zvogëlimit të kapitalit me qëllim që ai t'i bëjë të ditur ortakëve vlerësimin e tij për shkaqet dhe kushtet e zvogëlimit. Zvogëlimi i kapitalit nën minimumin ligjor për shpk (100.000 leke) detyron shoqërinë të shndërrohet në një formë tjetër.Në këtë rast, shoqëria do të marrë vendim për rritjen e tij të paktën deri në vlerën e mësipërme.

NENI 14

FITIMI, NDARJA E TIJ.

Cdo kuotë zotëruese, i jep të drejtë Ortakëve të marrin pjesë në fitimet e shoqërisë. Fitimi që rezulton nga aktiviteti ndahet midis ortakëve, pasi më parë të jenë zbritur nga të ardhurat, shpenzimet e nevojshme, si detyrime ndaj të tretëve, tatime, taksa etj.Pjesët e fitimit përcaktohen sipas kontributit të pjesëve të secilit ortak për krijimin e kapitalit themeltar dhe përkatësisht:

1. ENDRI FUGA me 55 % (pesëdhjetë e pesë) për qind.
2. ARBJAN MAZNIKU me 30 % (tridhjetë) për qind.
3. SOKOL SHAMETI me 15 % (pesëmbëdhjete) për qind.

NENI 15

FONDI "REZERVE E DOMOSDOSHME"

Ortakët bien dakort që nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur po të jetë e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, të lenë menjënjë shumë me vlerë të paktën sa 1/20 e tij, e destinuar për formimin e fondit "rezerva e domosdoshme", i cili do të shërbejë për kapitalizim të fitimeve, përballim të nevojave të domosdoshme, etj. Kjo lënie mënjanë nuk është e detyrueshme kur arrin në 1/10 e kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 14

STRUKTURA ORGANIKE E PUNESIMIT

Shoqëria lidh kontrata pune individuale ose kolektive me personat e punësuar në bazë të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë. Hartimi i Organizave dhe krijimin e vendeve të punës, do të bëhet me Vendim të Asamblesë së Shoqërisë.

NENI 15

PRISHJA E SHOQERISE. LIKUIDIMI

Përfunduar rasti i prishjes në rrugë gjyqesore, shoqëria priset: në cdo kohë me Vendim të Asamblesë së Jashtezakonshme të Ortakëve. Prishja e shoqërisë sjell likuidimin e saj. Likuidimi kryhet nga një apo disa Likuidatorë të emëruar nga Asambleja në kushtet e shumicës. Pas emerimit të Likuidatorit, cdo akt që del prej shoqërisë nënshkruhet prej tij. Ai ka kompetencë të plotë për shitjen e aktivitet të saj për të shlyer kreditorët dhe për shpërndarjen e mbetjeve të disponueshme. Aktivi neto pas shlyerjes së vlerës nominale të cdo kuote ndahet midis ortakëve në përpjestim me pjesëmarrjen në kapital.

NENI 16

MARJA PERSIPER E DETYRIMEVE

Ortakët që kanë nënshkruar këtë Statut, njohin detyrimet që rrjedhin prej tij.

NENI 17

PUBLIKIMET

Me qëllim që të kryhen publikimet lidhur me themelimin e shoqërisë të gjitha kompetencat i jepen Administratorit, zotit Endri Fuga, i cili :



- nënshkruan në kërkesën drejtuar Gjykatës për regjistrim.
- kryen formalitet e regjistrimit në Regjistrin Tregtar.

NENI 18 **SHPENZIMET**

Të gjithë shpenzimet, taksa e të tjera të paguara për themelimin e shoqërisë, i përkasin bashkërisht dhe solidarisht nënshkruesve në përpjestim me kontributin e tyre deri sa shoqëria të regjistrohet në Regjistrin Tregtar.

DISPOZITA TE FUNDIT

Gjykata kompetente

-Kompetente për gjykimin e mosmarveshjeve midis ortakëve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Sa më sipër Statuti nënshkruhet nga palet pa asnjë vërejtje, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, duke u garantuar edhe respektimi i përmbajtjes së tij.

Ky statut është i vlefshëm pasi i bashkëngjitet edhe Akti i Themelimi.


Hartuar në 4 ekzemplarë.

ORTAKET:


Arbjan Mazniku
emri, mbiemri, firma



ENDRI FUGA
emri, mbiemri, firma




SOKOL SHAMETI
emri, mbiemri, firma





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 8832 REP
NR 1074 KOL.



VERTETIM NENSHKRIMI

Në Tiranë, sot më datë 02 tetor 2006, para meje, noter Ilirion Shalizi anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqiten personalisht:

- 1. ENDRI FUGA**, biri i Përparimit, dl. 11.11.1981, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga e Barrikadave, pallati 4, ap.10, me nr. Pasaporte Z 0680666,
- 2. ARBJAN MAZNIKU**, biri i Cvetkos, dl. 06.11.1978, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga “Arkitekt Kasemi” nr.24, me nr.pasaporte Z 0788959,
- 3. SOKOL SHAMETI**, biri i Avdulit, dl. 29.04.1978, lindur në Gjirokastrë, banues në Tiranë, Rruga “Fadil Rada”, pallati 11, shkalla 2/36, me nr.pasaporte Z 0599048, të tre me zotesi juridike të plotë për të vepruar që kërkuan prej meje vërtetimin e nënshkrimeve të tyre të vëna jashtë kësaj zyre në STATUTIN e Shoqërisë tregtare “A.C.G “ shpk (Albanian Communication GROUP). Pasi u binda për vullnetin e shprehur lirisht dhe se nënshkrimet janë të tyre, vërtetoj rregullisht në bazë të ligjit.

NOTER

Ilirion Shalizi

KËRKESË

**GJYKATËS SË RRETHIT GJYQSOR TIRANË
SEKSIONIT TREGTAR**

KËRKUESI:

Shoqëria A.C.G. sh.p.k. (Albanian Communication Group), shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë me vendim nr. 37027 të datës 05.10.2006 e përfaqësuar nga Av. Klotilda (Ferhati) Bushka ("Shoqëria").

OBJEKTI:

Depozitimi në Rregjistrin Tregtar të kësaj Gjykate i Vendimit Mbledhjes së Ortakëve të Shoqërisë datë 08.02.2007 si edhe i Kontratës së Transferimit të Pjesëve të Kapitalit të Shoqërisë midis Z. Sokol Shameti dhe Z. Endri Fuga datë 08.02.2007.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Dispozitat që rregullojnë Pjesën Parë të Kodit Tregtar", Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare dhe Ligji Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria A.C.G. sh.p.k. është regjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë me vendim nr. 37027 të datës 05.10.2006.

Më datë 08.02.2007 është lidhur Kontrata për Transferimin e Pjesëve të Kapitalit midis ortakut Z. Sokol Shameti dhe ortakut tjetër Z. Endri Fuga nepermjet se ciles Z. Sokol Shameti që zotëron 15 pjesë kapitali ose 15 % të kapitalit të Shoqërisë I ka transferuar nepermjet shitjes keto pjesë kapitali tek ortakut Z. Endri Fuga.

Me date 08.02.2007 me vendimin e Asamblese se ortakeve te Shoqerise eshte vendosur:

- Miratimi i transferimit nëpërmjet shitjes të pesëmbëdhjete pjesëve të kapitalit të Shoqërisë që përbëjnë 15 % (pesëmbëdhjete përqind) të kapitalit të Shoqërisë nga ortakut i saj Sokol Shameti tek ortakut tjetër Endri Fuga si miratimi i Kontrates perkatase per transferimin e pjesëve te kapitalit date 8.2.2007;
- Si rrjedhojë e vendimeve sa më sipër struktura e kapitalit të Shoqërisë është si më poshtë:

Ortaku	Zoterimi i pjesëve të kapitalit në %	Nr. Pjesëve të kapitalit	Vlera në Leke e kapitalit të Shoqërisë
Endri Fuga	70	70	70.000
Arbjan Mazniku	30	30	30.000

Me vendimin e Asamblese se ortakeve te Shoqerise eshte autorizuar Av. Klotilda (Ferhati) Bushka me nr. License 1823 per te ndjekur te gjithë procedurat per regjistrimin e vendimit te asamblese se Shoqerisedate 8.2.07 si dhe te Kontrates per transferimin e pjesëve te kapitalit nga ortakut Sokol Shameti tek Z. Endri Fuga, ne organet gjyqesore duke perfshire te drejten e nenshkrimit te cdo akti ne permbushje te qellimit te mesiperm.

Në këto kushte i kërkoj Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë të depozitojë në Rregjistrin Tregtar të kësaj Gjykate Vendimin e Mbledhjes se Ortakëve datë 08.02.2007 si edhe Kontraten e Transferimit të Pjesëve të Kapitalit të lidhur midis Z. Sokol Shameti dhe Z. Endri Fuga më datë 08.02.2007.

KËRKUESI
Av. Klotilda (Ferhati) Bushka

Klotilda (Ferhati) Bushka


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 661 Rep.

Nr. - Kol.

VËRTETIM

Sot, më datë 14.02.2007, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres *f. HSH* Notere pranë Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit personalisht Av. Klotilda Ferhati Bushka, me n. License 1823 me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të ciles u binda pasi verifikova pasaportën e saj, e cila më deklaroi se e ka përpiluar këtë Kërkesë jashtë Zyrës së Noteres, me vullnetin e saj të lirë, Kërkesë të cilën e nënshkroi përpara meje dhe unë e vërtetoj atë sipas kërkesave të ligjit.



NOTERE

meletta HSH
f. HSH

37027 } .. M. Huga
105 05.10.2006
TETOR 2006
[Signature]

KERKESE

RRUES: Shoqëria "A.C.G" shpk (Albanian Communication GROUP)
përfaqësuar nga Administratori Endri Fuga.

JEKTI : Regjistrimi i personit juridik.

ZA LIGJORE : Ligji 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", Ligji
7 datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar" dhe formalitetet...."

60 regjistrimi
Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 04.05.10.06

Me vullnetin e lirë të palëve është hartuar Statuti dhe Akti Themelimi për
min e Shoqërisë "A.C.G" shpk(Albanian Communication GROUP).

Ortakë themelues të saj, kontributi në krijimin e kapitalit themelues dhe
është takuese të fitimit janë : Endri Fuga në 55 %, Arbjan Mazniku në 30%
Sokol Shameti në 15%.

Kapitali themelues i shoqërisë është në para në vlerën 100.000 lekë.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :

- 1.Veprimtari në fushën e botimeve vecanerisht:
mi i Revistes "MAPO" (Magazina Popullore). *Statut*
- 2.Import- Export i lëndëve të para dhe teknologjise për shtypshkrime. *Fondet Bankare*
- 3.Veprimtari marketingu:
shën e reklamave, publikimeve,
ata promovuese. *Nr 0106799918*
- 4.Sondazhe (anketime).
- 5.Konsulencë për marrëdhënie me publikun dhe komunikim.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së saj është e pakufizuar.

Administratori i shoqërisë caktuar në statut është Zoti Endri Fuga.
Qendra, (selia) e shoqërisë është në Tiranë, rruga "Gjin Bue Shpata"
nr 9/a, Ap.48.

Me cilësinë e përfaqësuesit ligjor të saj paraqes kërkesën për
regjistrim.Asaj i bashkëngjiten Statuti dhe Akti i Themelimit, certifikata e
tësit të fondeve që rrjedh nga shlyerja e pjesëve të kapitalit
themelues.Kërkesa bazohet në ligj, prandaj :

KERKOJ

Pranimin e saj.

**Regjistrimin si person juridik të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“A.C.G” shpk (Albanian Communication GROUP) me ortakë z.Endri
Fuga, z.Arbjan Mazniku dhe z.Sokol Shameti.**

Kapitali themeltar i shoqërisë është në para në vlerën 100.000 lekë.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :

1.Veprimtari në fushën e botimeve, vecanërisht:

- botimi i Revistes “MAPO” (Magazina Popullore).
- 2.Import- Export i lëndëve të para dhe teknologjisë për shtypshkrime.
- 3.Veprimtari marketingu:
- në fushën e reklamave, publikimeve,
- fushata promovuese.
- 4.Sondazhe (anketime).
- 5.Konsulencë për marrëdhënie me publikun dhe komunikim.

Kohëzgjatja e veprimtarisë së saj është e pakufizuar

Administratori i shoqërisë caktuar në statut është Endri Fuga

Qendra, (selia) e shoqërisë është në Tiranë, rruga “Gjin Bue Shpata”

Pallati 9/a, Ap.48.

KERKUES

Shoqëria “A.C.G” shpk - (Albanian Communication GROUP)

Përfaqesuar nga Administratori

ENDRI FUGA


ENDRI FUGA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 8833 REP

NR 1075 KOL



VERTETIM NENSHKRIMI

Në Tiranë, sot më datë 02 Tetor 2006, para meje, noter *Ilir Mehmeti*, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit personalisht:

Zoti ENDRI FUGA, biri i Përparimit, dl. 11.11.1981, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga e Barikadave, pallati 4, ap.10, me nr. Pasaporte Z 0680666, me zotësi juridike të plotë për të vepruar, i cili kërkoi vërtetimin e nënshkrimit, vënë jashtë kësaj zyre në Kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e shoqërisë "A.C.G" shpk (Albanian Communication GROUP).

Pasi u binda për vullnetin e shprehur lirisht dhe se nënshkrimi i mësipërm është bërë prej tij, vërtetoj rregullisht baze ligjit.

NOTER

Ilir Mehmeti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

N. 551 Rep

N. 211 Kol

**KONTRATË PËR TRANSFERIMIN E PJESËVE TË KAPITALIT TË
SHOQËRISË A.C.G. SH.P.K. (ALBANIAN COMMUNICATION GROUP)**

Sot, më datë 08.02.2007, në orën 11.00, përpara meje Noteres
A. Ballkuci, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, u lidh kjo kontratë
shitblerjeje pjesësh kapitali (më poshtë quajtur "Kontrata"),

Midis


Z. Sokol Shameti, shtetas shqiptar, i biri i AVDYI lindur në GJIROKASTË më
29.04.1978 me banim në Tiranë, në Rruga F. RANA, TIRANË, dhe me pasaportë
n. 779000 DEHTI AUTOMATIK cilësinë e ortakut të Shoqërisë A.C.G. sh.p.k.
(Albanian Communication Group) - ("Shitësi");

dhe

Z. Endri Fuga, shtetas shqiptar, i biri i Përpashaj lindur në Tiranë, më
11.11.1981 me banim në Çirçani Tiranë, dhe me pasaportë n.
Çirçani 1-4 cilësinë e ortakut të Shoqërisë A.C.G. sh.p.k. (Albanian
Communication Group) - ("Blerësi");

Kushtet Paraprake

1. Shitësi zoteron 15 (pesëmbëdhjete) pjese kapitali (kuota) të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare A.C.G. sh.p.k. (Albanian Communication Group), (më poshtë referuar si "Shoqëria"), regjistruar si person juridik me vendim nr. 37027 të datës 05.10.2006 të



Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Këto pjesë kapitali në zotërim të Shitesit përbejnë 15 % (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë dhe kanë një vlerë nominale prej 15 000 Leke (pesëmbëdhjetë mijë);

2. Blerësi dëshiron të blejë dhe Shitësi dëshiron të shesë pjesët e kapitalit të Shoqërisë përmendur në pikën 2 të Kushteve Paraprake, sipas kushteve të mëposhtme.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, palët bien dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Kushtet Paraprake

Kushtet paraprake dhe shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

Neni 2

Objekti i Kontratës

Shitësi i shet Blerësit që blen 15 (pesëmbëdhjetë) pjesë të kapitalit (kuota) që Shitesit zotëron në kapitalin e Shoqërisë të barabartë me 15 % (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 3

Cmimi dhe mënyra e pagesës

- 3.1 Cmimi i shitjes së pjesëve të kapitalit të Shoqërisë parashikuar në këtë Kontratë është 15 000 Lekë (pesëmbëdhjetë mijë Lekë).
- 3.2 Shitësi deklaron se cmimi i shitjes së pjesëve të kapitalit të Shoqërisë parashikuar në këtë Kontratë është paguar krejtësisht nga Blerësi para nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 3.3 Që nga momenti i nënshkrimit të Kontratës Blerësi fiton automatikisht të drejtën e pronësisë mbi 15 (pesëmbëdhjetë) pjesë të kapitalit të Shoqërisë që

Handwritten signature and initials in black ink, appearing to be 'F' and '22'.

përbëjnë 15 % (pesëmbëdhjete përqind) të kapitalit të saj dhe Shitesi zhvishet nga pronësia mbi këto pjesë kapitali.

Neni 4

Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve

- 4.1. Blerësi merr përsipër blerjen e pjesëve të kapitalit të Shoqërisë me cmimin e përcaktuar nga kjo Kontratë. Blerësi fiton edhe të drejtat e dividendit që rrjedhin nga fitimi i vitit financiar 2006 (nëse do të ketë).
- 4.2. Shitesi deklaron se pjesët e kapitalit që i kalohen Blerësit janë plotësisht të lira nga çdo barrë, apo detyrim në favor të të tretëve, dhe merr përsipër të dëmshpërblejë Blerësin për çdo dëm apo humbje të pësuar nga ky i fundit nga pretendimet e të tretëve ndaj pjesëve të kapitalit.
- 4.3. Shitesi deklaron gjithashtu të ketë përmbushur çdo detyrim, që rrjedh nga cilësia e të qënurit ortak i Shoqërisë në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Në rast mospërmbushje të këtij detyrimi, Shitesi merr përsipër të dëmshpërblejë Blerësin për çdo dëm apo humbje, pasojë e mospërmbushjes.

Neni 5


Shpenzimet

Taksat e pullës dhe shpenzimet ligjore dhe noteriale që lidhen me nënshkrimin e kësaj Kontrate do të jenë në ngarkim të përbashkët të palëve. Detyrimet e tjera ligjore do të paguhen sipas dispozitave në fuqi.

Neni 6

Përmbajtja e Kontratës dhe ndryshimet

Kjo Kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparëshme me këtë objekt. Ndryshimet apo shmangiet e mundshme nga kjo Kontratë, mund të bëhen vetëm me shkrim, do të nënshkruhen nga të gjitha palët dhe më pas i bashkëngjiten kësaj Kontrate.



3

Neni 7
Njoftimet

7.1. Të gjitha lajmërimet, kërkesat dhe njoftimet e tjera mes palëve, duhet të bëhen me shkrim dhe të dërgohen në adresat e mëposhtme:

- (i) Për Shitësin: Rr. F. Rada TIRANE
(ii) Për Blerësin: Rr. Elbasanit, nr. 77, TIRANE

7.2. Lajmërimet, kërkesat dhe njoftimet e tjera do të dërgohen me letër rekomande ose me faks.

7.3. Çdo informacion, kërkesë apo njoftim do të ketë fuqi vetëm nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) dërgohet me faks, dhe do të ketë fuqi në momentin në të cilin merret faksi; b) dërgohet me letër rekomande, dhe do të ketë fuqi në datën e marrjes, që rezulton nga firmosja e marrjes në dorëzim.


Neni 8


Legjislacioni i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve


8.1. Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.


8.2. Çdo mosmarrëveshje midis palëve që rrjedh nga apo lidhet me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Kontrate, e cila nuk mund të zgjidhet miqësisht mes palëve, do t'i kalohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë.

Unë Noterja, ia lexova palëve këtë Kontratë, që është hartuar në katër kopje origjinale, të cilat deklaruan se e gjejnë atë plotësisht në përputhje me vullnetin e tyre dhe e nënshkruan në praninë time, dhe Unë Noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

ZENDRI FUGA




TIRANE, 02.09.2019, 12:42



Johol Shumet


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 8831 Rep
Nr. 1073 Kol.



VERTETIM

Sot me date 02.10.2006 (dymije e gjashte) ne Dhomen e Notereve ne Tirane para meje Noteres Shkendie Shahu , me seli ne rrugen e " Durresit " Nr. 38 , u paraqit personalisht Z. Endri Fuga , I biri I Perparimit , I datelindjes 11.11.1981 , lindur dhe banues ne Tirane, me Nr. pasaporte Z 680666 , madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar , Z. Arbjan Mazniku , I biri I Cvetkos , I datelindjes 06.11.1978, lindur dhe banues ne Tirane, me Nr. pasaporte Z 0788959 , madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe Sokol Shemeti , I biri I Avdulit , I datelindjes 29.04.1978, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, me Nr. pasaporte Z 0599048 , madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet deklaruan se kane hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote Aktin e Themelimit te Shoqerise " A.C.G " SHPK . (ALBANIAN COMMUNICATION GROUP " nenshkruan rregullisht para meje noteres dhe une noterja e vertetoj ne baze te ligjit .


[Faint stamp and handwritten signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERËVE TIRANË

N. 590 REP

N. 212 KOL



**VENDIM I ASAMBLESE SË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR A.C.G.
SH.P.K. (ALBANIAN COMMUNICATION GROUP)**

Më datë 08.02.2007, në orën 11.00 përpara meje A. Mallkuqi, notere në Tiranë, anëtare e Dhomës së Noterëve të Tiranës,

u paraqiten

Z. Endri Fuga, shtetas shqiptar, i biri i Përpallur, lindur në Tiranë, më 11.11.1981 me banim në Lezgjari Tiranë, dhe me pasaportë n. _____ në cilësinë e ortakut të Shoqërisë **A.C.G. sh.p.k. (Albanian Communication Group)** që zoteron 55 % (pesedhejte përqind) të kapitalit të saj;

Z. Arbjan Mazniku, shtetas shqiptar, i biri i _____, lindur në Tiranë, më 6.11.1978, me banim në Lezgjari Tiranë, dhe me pasaportë n. 22027647 në cilësinë e ortakut të Shoqërisë **A.C.G. sh.p.k. (Albanian Communication Group)** që zoteron 30 % (tridhjetë përqind) të kapitalit të saj;

Z. Sokol Shameti, shtetas shqiptar, i biri i Avdyzit, lindur në Tiranë, më 29.04.1978, me banim në Rr. F. Rodari Tiranë, dhe me pasaportë n. 779000 ^{GJIBOKASTER} BESH HI AUTOMKTI në cilësinë e ortakut të Shoqërisë **A.C.G. sh.p.k. (Albanian Communication Group)** që zoteron 15 % (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të saj;

Te gjithë madhore dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

(ne vijim **A.C.G. sh.p.k. (Albanian Communication Group)** do të quhet “Shoqëria”);

Personat me sipër zoterojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë dhe në këtë mbledhje

Vendosi

- të miratojnë transferimin nëpërmjet shitjes të pesëmbëdhjetë pjesëve të kapitalit të Shoqërisë që përbëjnë 15 % (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë nga ortaku i saj Sokol Shameti tek ortaku tjetër Endri Fuga si dhe të miratojë Kontraten perkatëse për transferimin e pjesëve të kapitalit date 08.02.2007;
- Si rrjedhojë e vendimeve sa më sipër struktura e kapitalit të Shoqërisë është si më poshtë:

Ortaku	Zoterimi i pjesëve të kapitalit në %	Nr. Pjesëve të kapitalit	Vlera në Leke e kapitalit të Shoqerise
Endri Fuga	70	70	70.000
Arbjan Mazniku	30	30	30

- Autorizohet Av. Klotilda Ferhata Busuke me nr. License 1623 per te ndjekur te gjithë procedurat per regjistrimin e ketij vendimi te asamblese se Shoqerise si dhe te Kontrates per transferimin e pjeseve te kapitalit nga ortaku Sokol Shameti tek Z. Endri Fuga, ne organet gjyqesore duke perfshire te drejten e nenshkrimet te cdo akti ne permbushje te qellimit te mesiperm. Av. K. Ferhata Busuke ka te gjitha kompetencat e nevojshme per te kryer te formalitetet e parashikuara ne lidhje me depozitimin e ketij vendimi dhe akteve te parashikuara ne te ne organet kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

Ky akt u hartua nga unë Notere A. Hallkuja dhe u nënshkrua nga ortaket e Shoqerise me vullnetin e tij të lirë e të plotë dhe unë e vërtetoj atë sipas Ligjit.

ORTAKET

ENDRI FUGA

ENDRI FUGA

ARBJAN MAZNIKU

Arbjan Mazniku

SOKOL SHAMETI

Sokol Shameti

NOTERE